

Marrëveshje për Pagesën e Borxhit

Kjo Marrëveshje për Pagesën e Borxhit (në tekstin e mëtejme: marrëveshja), është lidhur ndërmjet palëve:

- **VAPIK - Visual Authors, Producers, and Interpreters of Kosovo**, me seli në rr. Luan Haradinaj, 10 000 Prishtina, Kosova. (tutje referuar si: VAPIK)

dhe

- **OPTIMUM TELECOMMUNICATIONS L.L.C.** me numër unik identifikues 812030279 përfaqësuar nga Erdinand Mujaj.(tutje referuar si: Operatori)

VAPIK dhe Operatori mund të referohen individualisht si "palë" ose kolektivisht si "palët".

Duke qenë se VAPIK, në bazë të Mandatit që buron nga leja nr. 002-11712020 lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datë 07.11.2012, me Vendimin Nr.13/38 të datës 30.10.2020, të gjithë operatorët kabllorë që ritransmetojnë materiale vizuale me të drejtë autori, duhet të respektojnë dhe paguajnë tarifën e të drejtës së autorit tek VAPIK.

Duke qenë se palët kanë nënshkruar MARRËVESHJE PËR PAGESËN E TARIFAVE MUJORE PËR SHFRYTËZIMIN E LËNDËS SË MBROJTUR ME RASTIN E RITRANSMETIMIT e datës 27.07.2024 (tutje referuar si marrëveshja bazë) .

Prandaj, tani, Palët bien dakord të paguajnë borxhin sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1

1. Operatori kabllor pranon të paguaj borxhin e akumuluar sipas pikës I të marrëveshjes bazë.

Neni 2

1. Palët pajtohen që borxhi i akumuluar të paguhet sipas ratave si në aneksin 1 - plani i pagesave.

Neni 3

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të mbetet në fuqi derisa borxhi i akumuluar të paguhet plotësisht.

Neni 4

1. Palët pajtohen se kompetencë për zgjidhjen e kontesteve që burojnë nga kjo Marrëveshje është Gjykata kompetente ne Prishtinës.

Pas leximit dhe analizimit të tekstit të Marrëveshjes, Palët e nënshkruajnë pa vërejtje.

Operatori,

VAPIK - Visual Authors, Producers, and Interpreters of Kosovo

